



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:032254

Datë: 06.06.2024

Numri i dokumentit: 05792696

KPPP.nr.708/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit “NTT Sokoli” SH.P.K., me NUI: 810850190, me seli në rr. “Rexha Shema” Nr. 10, në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Fehmi Shala, avokat nga Prishtina, kundër debitorit “IPKO Telecommunications” SH.P.K., me NRB: 70064420, me seli në rr. “Zija Shemsiu” Nr. 34, në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Isamedin Dedinca, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.01/2022 të datës 11.01.2022 të Përmbartuesit Privat Fadil Hoxha, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 06.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “IPKO Telecommunications” SH.P.K., ANULOHET Urdhri Përmbartimor P.nr.01/2022 i datës 11.01.2022, i Përmbartuesit Privat Fadil Hoxha dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.
- II. DETYROHET kreditori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e prapësimit t’ia paguaj debitorit shumën prej 416.00 € (katërqind e gjashtëmbëdhjetë euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “NTT Sokoli” SH.P.K., me seli në Prishtinë, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.01/2022 të datës 11.01.2022, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës Nr. 01-08/21 të datës 25.08.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që pas pranimit të këtij urdhri t’i paguajë

kreditorit shumën prej 42,850.87 €, me kamatë ligjore prej 8 % në vit, duke filluar nga data e arritjes së borxhit për pagesë, e deri në ditën e pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbimore, ashtuqë të gjitha këto detyrime të realizohen përmes bllokimit të llogarive bankare.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar, e ka kundërshtuar urdhrin përmbimor duke theksuar se fatura në bazë të të cilit është caktuar përmbimimi nuk paraqet dokument të besueshëm, për faktin se fatura nuk është nënshkruar nga debitori, si dhe kreditori nuk ka kontraktuar nga debitori kryerjen e shërbimeve siç ceket në faturë, me anë të së cilës nënkuptohet se kreditori nuk ka kryer punë për debitorin. Më tutje ka shtuar se gjatë viteve të bashkëpunimit në mes të kreditorit dhe debitorit për secilën punë të kryer ekziston një kontratë paraprake e nënshkruar nga të dy palët, ndërsa në rastin konkret nuk ekziston asnjë marrëveshje dhe porosi për këto punime. I ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin e debitorit në tërësi, si dhe të detyrohet kreditori që t'i paguaj shpenzimet e procedurës përmbimore në shumën prej 416.00 €.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka kundërshtuar prapësimin e debitorit, ku ndër të tjerash ka deklaruar se fatura e lartcekur përbën dokument të besueshëm dhe se fatura nuk është domosdo e detyrueshme të nënshkruhet nga debitori, ngase në bazë të nenit 20 parag. 1.17 të Udhëzimit Administrativ Nr. 15/20 për zbatimin të Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat përcaktohet se minimumi duhet që një faturë të nënshkruhet. Në lidhje me pretendimet e debitorit se gjatë viteve të bashkëpunimit të palëve ndërgjyqëse për secilën punë të kryer ekziston një kontratë paraprake, ka theksuar se në rastin konkret është e vërtetë se nuk ka kontratë të bashkëpunimit, por që vetë fakti se kreditori ndërton material për rrjeta të telekomunikacionit, pas ndërtimit i ofron operatorit që shpreh interesim i mundësohet që të lidhet me një marrëveshje dhe kompensim, andaj palët kanë pasur bashkëpunim të ndërsjellë dhe se mund të vërtetohet fakti se debitori përfiton nga shërbimet e kryera sipas kësaj fature. Gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar, si dhe të ka kërkuar kompensimin e përgjigjes në prapësim në shumën prej 208.00 €.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe

plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura Nr. 01-08/21 e datës 25.08.2021, në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbartimor, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm përmbartimor po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi përmbartimor paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti - fatura në bazë të së cilës është lejuar propozimi përmbartimor nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht e njëjta nuk përmban nënshkrimin e pranuesit - debitorit dhe nuk ka dëshmi se është pranuar nga debitori në çfarëdo forme. Andaj duke qenë së debitori nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt këtë faturë, e njëjta nuk mund të shërbej si dokument i besueshëm.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të kreditorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbartimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbartimor.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti mbi të cilin mbështetet propozimi përmbartimor, e mbi bazën e të cilit Përmbartuesi Privat ka lejuar përmbartimin, nuk mund të shërbej si dokument i besueshëm pasi që nuk ka tipare të përmbartueshmërisë.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbarimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të neneve 452 par.1, 453 dhe 463 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke i'a njohur debitorit shpenzimet për përpilimin e prapësimit dhe atë në shumën prej 416.00 €.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.708/23, datë 06.06.2024

Gjyqtari
Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.